

## **GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS**

**PKr. Nr. 383/09**

**9 shtator 2014**

Aktgjykimi i publikuar mund te mos jete i formës se prere dhe munde te jetë objekt i ankesës ne baze te ligjit te aplikueshëm.

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS - Departamenti i Krimeve të Rënda me trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Piotr Bojarczuk si kryetar i trupit gjykues, gjykatësja e EULEX-it Mariola Pasnik dhe gjykatësja kosovare Nora Bllaca-Dula si anëtarë të trupit gjykues, me ndihmën e Asistentit Ligjor të EULEX-it Musa Bajraktari, në çështjen penale PKR. 383/2009 kundër të akuzuarve në vijim, të akuzuar me aktakuzën e Prokurorit të Shtetit PP. nr. 465-6 / 09, të datës 13 Gusht 2009 dhe të konfirmuar me aktvendimin e Gjyqtarit për konfirmim, KA. Nr. 348/09, të datës 05.10.2009, në çështjen penale kundër:**

**1. A.C., emri i babait xxxx, emri i nënës xxxxx, mbiemri i vajzërisë xxxx, i lindur më xxxx në xxxx i akuzuar për veprat penale në vijim:**

1.1.'Që me datën 22.05.2009, rreth orës 13:40, në fshatin Z. i U., Komuna e D., në afërsi të xhamisë së fshatit, për shkak të marrëdhënieve të acaruar dhe konflikteve të vazhdueshme në mes të pandehurit A.C. me të bijën e të ndjerit R.A., Q.A., me të cilën i pandehuri A.C. ishte i martuar, dhe për shkak të dhunës së vazhdueshme që përdorte kundër saj burri i saj, ajo braktiste shtëpinë e saj shumë herë dhe shkonte në shtëpinë e babait të saj, me tipin e automjetit "Mercedes", ngjyrë hiri, pronë e të pandehurit të dytë, e cila përdorej nga i pandehuri R.. A.C. la shtëpinë e tij në fshatin K., ai shkoi në fshatin Z. i U. në afërsi të xhamisë, ku ai parkoi automjetin dhe priti rreth 30 minuta për babain (tani të ndjerin) e ish-gruas së të pandehurit A.C., i cili në atë kohë ishte brenda në xhami duke u lutur, automjeti i të cilit ishte vënë re nga i pandehuri A.C. se ishte i parkuar përpara, prandaj ai e dinte se ai ishte aty, kështu që

kur i ndjeri doli nga xhamia dhe iu afrua automjetit të tij, për shkak të hakmarrjes së paskrupullt, duke menduar se ai ishte arsyaja pse bashkëshortja e tij nuk po kthehej në shtëpi, i pandehuri A.C. me qëllim që ta privojë atë ngajeta, iu afrua të ndjerit dhe në një distancë prej 3-4 metra larg, qëlloi katër herë me armë automatike kundër tij, duke e goditur atë me katër plumba në pjesët vitale të trupit të tij, duke i shkaktuar plagë vdekjeprurëse, për shkak të të cilave personi ka vdekur menjëherë. Pas kryerjes së veprës penale, me të njëjtin automjet ai u kthye në shtëpinë e tij në fshatin K..

e cila në aktakuzë u klasifikua si vrasje e rëndë nga neni 147, pika 9 e Kodit Penal të Kosovës (më tej "KPK");

1.2 "Që në datën, orën dhe vendin e përshkruar më sipër në pikën 1, pa pasur një leje të vlefshme të lëshuar nga autoriteti kompetent (Ministria e Punëve të Brendshme të Kosovës) për pronësinë e autorizuar të armëve të tillë, ai ishte në posedim të armës së zjarrit automatik "AK-47", (kalibër 7.62x39mm, me numër serik 09809-84) të cilën ai e mori nga shtëpia e tij dhe ka kryer veprën penale të përshkruar më sipër në pikën 1;

e cila në aktakuzë u klasifikua si mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 paragrafi 2 i KPK-së në lidhje me veprën penale të përshkruar më lartë në pikën 1;

2. **R.O.**, emri i babait xxxx, emri i nënës dhe mbiemri i vajzërisë xxxxx , i lindur më xxxx në xxxx, i akuzuar për veprën penale në vijim:

2.1."Që në ditën, orën dhe vendin e përshkruar në pikën I.1 më lart ai ka marrë pjesë në ndihmë, duke pritur brenda automjetit rreth 30 minuta, gjersa i pandehuri i parë shkaktoi vdekjen e të ndjerit R. A.',

e cila në aktakuzë u klasifikua si vepër penale e ndihmimit të vrasjes së rëndë në bazë të nenit 147 paragrafi 1, pika 9, në lidhje me nenin 25 të KPK-së;

Pas mbajtjes së seancave kryesore të gjykimit në publik më 15,18 nëntor dhe 11 dhjetor 2013 dhe 17, 21, 23, janar, 13 shkurt, 7 mars 2014, 11 prill 2014, 2 korrik 2014 dhe 5 shtator 2014;

Në prani të:

- akuzuarit A.C. dhe avokatit të tij mbrojtës D. R.;
- akuzuarit R.O. dhe avokatit të tij mbrojtës, I. D.; më 7 mars 2014 i akuzuari R.O. ishte përfaqësuar nga B. A., dhe
- palës së dëmtuar Z. A. dhe përfaqësuesit të saj R. G.;

Pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 5 shtator 2014 trupi gjykues, në bazë të nenit 359 paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë KPPRK;

Më 9 shtator 2014, në përputhje me nenin 359 të KPP-së, shpall publikisht si vijon:

## **AKTGJYKIM**

**I. A.C.është FAJTOR për shkak se:**

më 22.05.2009, rreth orës 13:40, në fshatin Z. i U,, Komuna e D., në afersi të xhamisë së fshatit:

ai ishte në posedim të armës automatike të zjarrit "AK-47 kalibr 7.62x39mm me numër serik 09809-84 pa Leje për Autorizim të Armëve apo leje e cila ishte një kategori e armës A2, siç përcaktohet në nenin 4 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1.2 i Ligjit për Armët të datës 17 shtator 2009 (Ligji 03 / L-143), dhe:

ai përdori qëllimi AK-47 në atë mënyrë që ai mori në shenjë dhe shtiu katër herë në R.A. i cili ishte duke qëndruar para oborrit të xhamisë, gjatë hapjes së derës së makinës së tij, ku rreth 20 njerëz të tjerë ishin duke u larguar nga xhamia pas kryerjes së namazit të xhumasë;

dhe me këtë veprim A.C. privoi ngajeta me dashje direkte të ndjerin R.A. duke e goditur atë me katër plumba në pjesët vitale të trupit të tij, duke i shkaktuar atij plagë vdekjeprurëse, për shkak të të cilave personi vdiq menjëherë;

dhe duke vepruar kështu A.C. ka kryer në bashkëveprim veprat penale në vijim:

**I.1. Posedim i paautorizuar i armës nga nenii 374 paragrafi 1 të KPRK;**

**I.2 Vrasje të rëndë sipas nenit 147, pika (9) të KPK;**

**II. Prandaj, A.C. DËNOHET:** në përputhje me nenin 3, paragrafin 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës që ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013 (në tekstin e mëtejshmë "KPRK") në lidhje me nenin 374 paragrafi 1 i KPRK për veprën penale të posedimit të paautorizuar të armëve sipas nenit 374 paragrafi 1 i KPRK përshkruar nën I.1 me dy (2) vjet burgim;

**II.1.**      në pajtim me nenin 3, paragrafin 2 të KPRK në lidhje me nenin 147, pika 9 të KPK-së, për veprën penale të vrasjes së rëndë me burgim afatgjatë për një periudhë prej 25 (njëzet e pesë) vjet;

**II.2.**      në pajtim me nenin 3, paragrafi 2 i KPRK në lidhje me Nenin 71 Paragrafët 1 dhe 2.1 të KPK-së për të dy veprat e përshkruara më lart A.C. me këtë rast është dënuar me një dënim unik prej 25 (njëzet e pesë) vjetëve burgim.

**III. Në përputhje me nenin 364 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të KPK-së nëpërmjet kësaj R. O. LIROHET për shkak se nuk është provuar sipas standardeve të kërkuar ose përtej dyshimit të arsyeshëm se më 22.05.2009, rrëth orës 13:40, në fshatin Z. i U., Komuna e D., në afërsi të xhamisë së fshatit, ai ka marrë pjesë në ndihmë, duke pritur brenda automjetit rrëth 30 minuta, gjersa i pandehuri i parë shkaktoi vdekjen e të ndjerit R.A.**

**IV. Në bazë të nenit 374 paragrafi (3) të KPRK, arma automatike e zjarrit "AK-47" me kalibrë 7.62x39mm, numri serik 09809-84, të konfiskohet menjëherë dhe të shkatërritet.**

**V. Pala e dëmtuar mund të ushtrojë çfarëdo kërkese për kompensim përmes gjykatave civile.**

**VI. Në bazë të nenit 365, paragrafi 1, pika 1.5 e KPPK-së periudha e heqjes së lirisë për A.C. nga 22 maji 2009 deri në 9 shtator 2014, do të përfshihet në dënimin unik me burgim afatgjatë i cili i është shqiptuar.**

**VII. Në bazë të nenit 453 paragrafët 1 dhe i KPPK-së, shpenzimet e procedurës penale do të kompenzojnë pjesërisht nga A.C. në një shumë të caktuar prej 100 euro dhe shpenzimet e mbeturat të procedurës penale do të paguhën nga burimet buxhetore.**

## **ARSYETIMI:**

I.Përbledhja procedurale :	.....
7II.Juridikioni i gjykatës:	.....
8III.Ligji i aplikueshëm procedural :	
gjykues: .....	8IV. Faktet e konstatuara nga trupi
seancën kryesore: .....	10V.Provat e administruara në
	12
VI.Vlerësimi i dëshmive: .....	
18Dëshmia e dëshmitarit Q.A.	..... 18
Dëshmia e dëshmitarit F. F.	.....
20Dëshmia e dëshmitarit Sh. G.	.....
21Dëshmia e O.M.	.....
22Dëshmia e dëshmitarit A. J.	.....
23Dëshmia e dëshmitarit A. H.	.....
24Dëshmia e A.C.	.....
24Dëshmia e M. C.	.....
25Dëshmia e dëshmitarit ekspert N. H.	.....
25	
Dëshmia e dëshmitarit ekspert N. M.	.....
26NJN e parë nga Republika e Kroacisë	.....
26	
NJN e dytë nga Republika e Kroacisë.....	
28NJN e parë nga Republika e Shqipërisë .....	
29NJNe dytë nga Republika e Shqipërisë .....	
30Dëshmitarët e tjerë dhe dëshmitë e dokumentuara	.....
30Deklaratat e dëshmitarit A.C.	.....
31	
Deklaratat e dëshmitarit R.O.	.....
.33VII.Kualifikimi	
ligjor:.....	

34VIII.Dënim:	.....
35	
IX. Shpenzimet e procedurave penale:	..... 36
X. Kërkesa pasurore juridike:	.....
38XI.Konkludim:	.....
<b><u>procedurale:</u></b>	<b>36Përbledhja</b>

1. Më 22 maj 2009, rrëth orës 13:40, në fshatin Z. i U., Komuna e D., në afërsi të xhamisë së fshatit, viktima R.A. u qëllua për vdekje.
2. Më 22 maj 2009, pas disa hapave hetimor Policia e Kosovës fillimisht arrestoi A.C. (rrëth orës 15:00) dhe më pas R.O. (rrëth orës 19:00). Policia dyshonte se ata të dy ishin të përfshirë në vrasjen e viktimit R.A.. Me një urdhër të gjykatës të dy të pandehurit ishin vendosur në paraburgim i cili iu kishte vazhduar disa herë deri në shpalljen e këtij aktgjykimi nga gjykata.
3. Më 24 maj 2009, Policia e Kosovës ka paraqitur kallëzimin penal nr. 2009-AG-0424 në Prokurorinë Publike të Prishtinës duke pretenduar se i pandehuri A.C. ka vrarë viktimin R.A., ndërsa i pandehuri tjetër, R.O. e ka ndihmuar A.C. në këtë vrasje.
4. Më 13 gusht 2009, Zyra e Prokurorisë Publike të Qarkut në Prishtinë ngriti Aktakuzën PP. nr. 465-6 / 09 duke akuzuar të pandehurin e parë, A.C., me Vrasje të rëndë, në shkelje të nenit 147, paragrafi 1, pika 9 të KPK-së dhe mbajtje në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në pajtim me nenin 328 paragrafi (2) i KPK-së, kurse i akuzuari i dytë, R.O., ishte akuzuar për Asistencë në kryerjen e veprës penale Vrasje e rëndë, në shkelje të nenit 147 paragrafi 1, pika 9, në lidhje me nenin 25 të KPK-së.
5. Më 5 shtator 2009, Gjykata e Qarkut në Prishtinë lëshoi aktvendimin e saj nr. KA.Nr.384 / 09 duke e konfirmuar aktakuzën në tërsi. Rasti vazhdoi me shqyrtim gjyqësor. Disa seanca gjyqësore ishin zhvilluar nga trupi gjykues i përbërë nga gjykatës vendorë, por rasti nuk ka përfunduar deri në tetor 2013. Më pas, i pandehuri ka paraqitur një peticion në Asamblenë e Gjyqtarëve të EULEX-it për të marrë rastin përsipër.

6. Më 8 tetor 2013, Kryetari i Asamblesë së gjiqtarëve të EULEX-it në bazë të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjiqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, (Ligji Nr.03 / L-053) vendosi t'ia caktoi rastin gjiqtarëve të EULEX-it.
7. Përbërja e re e trupit gjykues ka mbajtur seancat kryesore të gjykimit më 15, 18, nëntor dhe 11 dhjetor 2013 dhe 17, 21, 23, janar, 13 shkurt, 7 mars 2014, 11 prill 2014, 2 korrik 2014 dhe 5 shtator 2014.
8. Më 5 shtator 2014 gjykata shpalli vendimin e saj në një seancë të hapur në prani të palëve të lartpërmendura. I pandehuri i parë A.C. u shpall fajtor siç ishte akuzuar, ndërsa i pandehuri i dytë u lirua nga të gjitha akuzat.

## **II. Juridiksioni i gjykatës:**

9. Ligji i Gjykatave, Ligji nr. 03 / L-199 (LGJ) hyri plotësisht në fuqi më 1 janar 2013 (neni 43). Ky ligj rregullon juridiksionin territorial dhe substancial të Gjykatës në pajtim me nenet 9, 11 dhe 15.
10. Vepra bie brenda juridiksionit substancial dhe territorial të Gjykatës Themelore të Prishtinës (para 1 janarit 2013 Gjykata e Qarkut në Prishtinë). Vepra penale e vrasjes së rëndë mbart një dënim minimal prej të paktën 10 vjet dhe bie nën juridiksionin lëndor të Gjykatës Themelore në shkallë të parë (shih nenin 22 paragrafi (1.53) të Kodit të ri të Procedurës Penale 04 / L-123 (KPP) dhe nen 15 paragafët (1.11) dhe (1.21) të LGJ). Siç pretendon aktakuza se vepra penale është kryer në vendin e quajtur fshati "Z. i U.", komuna e G., ajo bie brenda juridiksionit territorial të Gjykatës Themelore të Prishtinës sipas nenit 29 paragrafi (1) i KPP-së dhe nen 9 paragrafi (2.1) i LGJ.
11. Trupi Gjykues i Gjykatës Themelore të Prishtinës ishte i përbërë në mënyrë korrekte nga një trup gjykues i përzier nga dy gjykatës të EULEX-it dhe një gjyqtar vendor në përputhje me nenin 4.7 të Ligjit mbi Juridiksionit. Asnjë çështje nuk është ngritur nga palët në lidhje me përbërjen e trupit gjykues.

## **III. Ligji i aplikueshëm procedural në fuqi:**

12. Duke trajtuar çështjen e së drejtës procedurale në fuqi në këtë rast, trupi gjykues vë në pah se më 1 janar 2013 Kodi i ri i Procedurës Penale hyri në fuqi në Kosovë. Kodi i Procedurës Penale (Nr. penal 04 / L-123) (KPP) ka zëvendësuar Kodin e Përkohshëm të

Procedurës Penale të Kosovës (i ndryshuar) (Rregullorja e UNMIK-ut 2003/26) (KPPK) (nenet 545 (2) dhe 547 të KPP-së). Dispozitat kalimtare dhe finale të cilat aplikohen përcaktojnë zbatimin e procedurës sipas KPP-së dhe zbatimin e vazhdueshëm të KPPKsë, në rrethana të veçanta.

13. Pasi që aktakuza ishte konfirmuar me vendim të formës së prerë para datës 1 janar 2013, neni 541 (2) e përcakton përdorimin e KPP, prandaj, gjykata vendosi për të kryer procedurat në përputhje me dispozitat e Kodit të ri të Procedurës Penale të Kosovës (2013).
14. Mendimi ligjor i Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 56/2013 të datës 23 janar 2013. Pika 1 e këtij mendimi ligjor thotë:

"nga data 1 janar 2013, në të gjitha procedurat penale të cilat janë në vazhdim e sipër të filluara para hyrjes në fuqi të këtij Kodi dhe në rastet në të cilat është ngritur dhe konfirmuar aktakuza... dispozitat e Kodit të ri do të zbatohen *mutatis mutandis* (neni 540, 541 i KPP-së) përvèç në rastet kur shqyrtimi gjyqësor tanimë ka filluar (neni 541.1 i KPP-së) "dhe

"neni 545 i KPP-së konsiderohet si një rregull e përgjithshme (*lex generalis*). Prandaj është e kuptueshme të jetë një rregull e përgjithshme që paraqitja e aktakuzës tregon nëse Kodi i vjetër apo i ri është i zbatueshëm "dhe

"Në lidhje me këtë, neni 541 i KPP-së konsiderohet *lex specialis*, duke specifikuar se Kodi i ri do të jetë i aplikueshëm në rastet, kur aktakuza është ngritur dhe konfirmuar para hyrjes në fuqi të KPP-së (paragrafi 2). Të dyja rastet i referohen situatës në terren se shqyrtimi kryesor ende nuk ka filluar dhe në këtë mënyrë ai do të kryhet në përputhje me dispozitat e Kodit të ri".

15. Trupi Gjykues ka trajtuar vendimin e Gjykatës Supreme me respekt të lartë, por mendimet e Gjykatës Supreme nuk janë të obligueshme. Sidoqoftë, Trupi Gjykues vendosi se neni 545 është *lex generalis* dhe neni 541 paragrafi 2 është *lex specialis*, e cila është gjithashtu në përputhje me interpretimin e mendimit juridik të Gjykatës së Lartë që formon një bazë të fortë për gjykaten për të vazhduar sipas Kodit të ri.

16. Kur ne shikojmë në fillim të të dy Kodeve, *Kapitulli një: Parimet dhe përkufizimet themelore*, ne do të shohim se parimet e përgjithshme janë të njëjtë për të dy Kodet. Dallimi kryesor i cili është i dukshëm në krahasim të të dy kodeve janë rregulloret rrith marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje dhe marrjes së tërthortë në pyetje të dëshmitarëve.

Kështu që Trupi Gjykues vendosi se në këtë rast Kodi i ri i mbron interesat e të gjitha palëve në mënyrë më të mirë sesa Kodi i Vjetër. Arsyesa e dytë është se rregulli i përgjithshëm në çdo anë të ligjit është se ligji i ri është më i mirë se Ligji i vjetër. Arsyesa e tretë është se ne fillojmë shqyrtimin gjyqësor nga fillimi dhe me anëtarë krejtësisht të ri kështu që për trupin gjykues ky shqyrtim gjyqësor nuk është vazhdim i gjykimit të vjetër; ky është një gjykim i ri. Prandaj, kodi i ri duhet të zbatohet.

17. Trupi gjykues gjithashtu thekson se në qoftë se ne e konsiderojmë këtë shqyrtim gjyqësor si një gjykim që tanimë ka filluar, ai do të ishte në kundërshtim me nenin 311 parografi 3 i KPP-së që lexon "... ose kur shqyrtimi gjyqësor mbahet para një kryetari tjetër të trupit gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të fillojë rishtas dhe përsëri të shqyrtohen të gjitha provat ...". Natyrisht, për momentin rasti i është caktuar Njësisë Mobile të Gjyqtarëve të EULEX-it dhe nuk do koment se rasti është duke u gjykuar para kryetarit të ri të trupit gjykues dhe duke marrë parasysh formulimin e qartë të ligjit "shqyrtimi kryesor fillon nga fillimi", kjo nuk lë vend për interpretim tjetër për gjykatën, por për të aplikuar Kodin e ri dhe se shqyrtimi kryesor fillon përsëri.

#### **IV. Faktet e vërtetuara nga trupi gjykues:**

18. Fillimisht gjykata do të paraqesë faktet të cilat janë konstatuar e pastaj ajo do të paraqesë provat e administruara gjatë shqyrtimit kryesor, si dhe analiza e atyre provave që ka rezultuar në konstatimin e fakteve të çështjes.
19. Nuk ka qenë e kontestueshme në mes të pandehurit A.C. dhe dëshmitares Q.A. se fillimisht ata ishin dashnorë për disa vjet dhe se më vonë ata u martuan. Për fat të keq, marrëdhënia e tyre u përkeqësua, sidomos pasi fëmija i tyre i parë lindi në vitin .... I pandehuri A.C. ka përdorur dhunë fizike dhe psikologjike ndaj gruas së tij në mënyrë të përsëritur derisa gruaja e tij ishte e detyruar ta braktisë atë dhe të shkoj për të jetuar në shtëpinë e prindërve të saj. Kujdestaria e fëmijëve i është besuar të pandehurit A.C.. Ky çift është ndarë dhe bashkuar disa herë. Imami O.M. ka ndërmjetësuar disa herë në mes të pandehurit A.C. dhe Q.A. si dhe anëtarëve të familjes të çiftit. Megjithatë, duket

se lidhja e tyre ishte e paqëndrueshme dhe për këtë arsyen hera e fundit që ata u ndanë ishte në janar ... dhe ata më nuk u bashkuan.

20. I pandehuri A.C. kishte kërkuar nga gruaja e tij që të kthehej në shtëpi disa herë. Çifti ka vazhduar të ketë komunikim në mes vete edhe pas janarit .... Megjithatë, dëshmitarja Q.A. kishte refuzuar që të kthehej mbrapa dhe të jetonte së bashku me A.C.. Ky i fundit ishte i mendimit se i ndjeri R.A., babai i gruas së tij, ishte një pengesë për çiftin që të bashkoheshin. Megjithatë, gjykata gjeti se nuk ka asgjë për të mbështetur këtë pohim. Përkundrazi, dëshmitari O.M. dëshmoi se fillimi i viktima R.A. përpinqej që të pajtonte çiftin. Dëshmitarja tjetër Q.A. deklaroi se viktima i kishte thënë asaj se ishte vendimi i saj nëse do të kthehej tek burri i saj apo jo.
21. Më vonë çifti u divorcua në gjykatë dhe kujdestaria e fëmijëve i takoi të pandehurit A.C..
22. Në ditën kritike, më 23 maj 2009, i pandehuri A.C. pasi që e ka vërejtur makinën e viktimit R.A. të parkuar në afërsi të xhamisë në fshatin Z. i U., Komuna e D. shkoi dhe u parkua në afërsi të xhamisë dhe ka pritur për viktimen e tij për të dalur nga xhamia. Ai ishte duke pritur jashtë xhamisë në një Mercedes ngjyrë hiri që ishte në pronësi të të pandehurit tjetër R.O.. Rreth orës 13:40 viktima R.A. doli nga xhamia dhe deshi të hyjë në makinën e tij. Në atë moment i pandehuri A.C. qëlloi disa herë viktimen R.A. i cili vdiq në vend. Pas të shtënavë ai u largua nga vendi i krimtit dhe u drejtua drejt K. dhe shkoi në shtëpi. Në atë kohë ai ia dërgoi një mesazh tekstual gruas së tij duke e njoftuar atë se ai ia vrapit duke përdorur gjuhë ofenduese "eja dhe merre trupin e kalbur në xhami". Kjo tregon se vrasja ishte e paramenduar dhe e planifikuar mirë paraprakisht. Vrasja është kryer nga një hakmarrje e paskrupullt kundër babait të gruas së tij. Gjykata konsideron se dëmi i supozuar që është bërë nga viktima R.A. ndaj të pandehurit A.C. dhe reagimi i këtij të fundit duke vrarë viktimen është shumë i pabarabartë. Vrasja e dikujt vetëm për shkak se viktima ka mbështetur vajzën e tij është shokuese dhe si e tillë ajo është një hakmarrje e qartë e paskrupullt.
23. Sa i përket të pandehurit R.O., prokuroria e cila e ka barrën e të provuarit, nuk ka qenë e suksesshme për të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i akuzuari R.O. ishte i pranishëm dhe ka ndihmuar A.C. në ditën kritike kur ka ndodhur vrasja. Prokuroria paraqiti disa prova të cilat ngrisin disa dyshime se i pandehuri R.O. ishte i pranishëm në ditën kritike në vendin e krimtit: makina e tij ishte e pranishme atë ditë në momentin kritik në afërsi të vendit të ngjarjes; ai është testuar si pozitiv për mbetjet nga të shtënat

me armë zjarri në dorën e djathët dhe një dëshmitar dëshmoi se ai mendonte se ishin dy persona në vendin e ngjarjes në ditën e vrasjes, pa qenë i sigurt dhe pa identifikuar ndonjërin prej personave që ishin në makinë. Të gjitha këto elemente janë të mjaftueshme për të mbështetur në rastin më të mirë një dyshim të bazuar se vepra penale ka ndodhur, por kurrë nuk janë të mjaftueshme për të përbushur standartet e të provuarit përtëj dyshimit të arsyeshëm. Teza e prokurorit ishte dëmtuar seriozisht nga gjetjet e ekspertëve nga Kroacia të cilët dëshmuan se ishte e mundur që të jenë transferuar mbetjet nga e shtëna me armë zjarri gjatë shtrëngimit të duarve apo duke e prekur më pas pushkën nga e cila është shtier. Përveç kësaj, teza e prokurorit ishte dobësuar nga përgjigjet e ekspertëve nga Shqipëria të cilët dëshmuan se nuk janë gjetur mbetje të të shtënavët në rrobat e të pandehurit R.O.. Më tej, eksperti ka dëshmuar se kalimi i periudhës 5 vjeçare të kohës kur janë bërë të shtënat e pretenduara nuk e bëjnë të pamundur gjetjen e mbetjeve të të shtënavët nga arma e zjarrit.

24. Për më tepër, mbrojtja paraqiti shumë dëshmitarë, të cilët edhe pse kishin arsyë të mjaftueshme për të dëshmuar në favor të të dy të pandehurve, sepse ata ishin të afërm , prokuroria nuk ishte në gjendje që të ofrojë ndonjë gjë gjatë marrjes së tërthortët në pyetje që do të dobësonin teorinë e tyre.
25. Prandaj, duke pasur parasysh të gjitha këto rrethana, gjykata ishte e detyruar të lirojë nga akuza të pandehurin R.O. për shkak të mungesës së provave bindëse që do të provonin përtëj çdo dyshimi të arsyeshëm fajësinë e këtij të pandehuri. Parimi i *in dubio pro reo* zbatohet në rastin në fjalë.

## **V. Provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor:**

26. Gjykata dëgjoi dëshmitarët në vijim:

- Q.A.
- Sh. G.
- A. J.
- A. H.
- F.F.
- Dëshmitarin ekspert - Doktor N. H.
- Oficerin e PK – L. R.

- Oficerin e PK – E. G.
- Oficerin e PK – R. B.
- Oficerin e PK – Sh. B.
- O.M.
- A. C.
- M. C.
- Dëshmitarin ekspert - Doktor N. M.

27. Gjykata dëgjoi deklaratat nga të dy të pandehurit:

- A.C.
- R.O.

28. Ekspertët mjeko-ligjorë dhe Raportet e mëposhtme:

- Zyra e mjekësisë ligjore –Raporti i autopsisë Raporti-MA09-136 R. A.-ekzaminimi është kryer nga Dr. M. G., DSc. Doktori i Mjekësisë Ligjore -EULEX-00643, me datë 27 maj 2009, (i shënjuar si fashikull 3, faqe 30);
- Fotografisti i Mjekësisë Ligjore:D. Sh.–Zyra e mjekësisë ligjore - Departamenti i Drejtësisë, MA09-136 me 23 maj 2009, (i shënjuar si fashikull 2);
- Fotografisti i Mjekësisë Ligjore: A. W., hetuesi i vdekjes: D. K., Zyra ekzaminuese mjekësore-Drejtësia e EULEX-it, Ex09-037, 22 maj 2009, Vendndodhja: Zabel i Poshtëm, (i shënjuar si fashikull 2);
- Raporti i autopsisë se seksionit të skenës së krimit-njësia regionale e mjekësisë ligjore -Prishtinë, datë 23.05.2009, (i shënjuar si fashikull 3, faqe 30);
- Raporti i Inspektimit të vendit- Njësia Rajonale e mjekësisë Ligjore -Prishtinë, i datës 22.05.2009, (i shënjuar si fashikull 3, faqe 30);
- Prosesverbali i marrjes së pyetje të të dyshuarit (A.C.) i përpiluar nga polici L. R.# 6240 i NJHR në Prishtinë, rasti nr. 2009-në AG-0424, i datës 23.05.2009 (i shënjuar si fashikull 3, faqe 29);
- Prosesverbali i marrjes në pyetje të të dyshuarit (R.O.) i përpiluar nga polici E.M. # 4775 i NJHR në Prishtinë, rast nr. 2009-në AG-0424, i datës 23.05.2009 (i shënjuar si fashikull 3, faqe 29);

- Akvendimi për paraburgimin e personit ndaj të arrestuarit A.C., i arrestuar më 22.05.2009, në ora 15:00, me 22.05.2009 (i shënjuar si fashikull 3, faqe 29);
- Aktvendimi për paraburgimin e personit ndaj të arrestuar R.O., i arrestuar më 22.05.2009, në orën 19:00, datë 22.05.2009 (i shënjuar si fashikull 3, faqe 29);

□

Memorandum zyrtar nga oficeri i policisë L. R. # PK6240- RAPORT KRIMINAL, i datës 24/05/ 2009 (i shënjuar si fashikull 3, faqe 28);

- Raporti fillestar/ i rastit nga Stacioni Policor i Drenasit, i datës 22.05.09 (i shënjuar si fashikull 3, faqe 28);
- Raporti Flash nga Policia e Kosovës, i datës 22.05.2009 (i shënjuar si fashikull 3, faqe 28);
- Raporti i oficerit të PK-së A. M. KPS7377, i datës 22.05.2009 (i shënjuar si fashikull 3, faqe 28);
- Raporti i oficerit të PK-së R. M. SHPK-2524, i datës 22.05.2009 (i shënjuar si fashikull 3, faqe 28);
- Raporti i oficerit të PK-së E.K. SHPK # 6620, i datë 22.05.2009 (i shënjuar si fashikull 3, faqe 28);
- Departamenti i skenës së krimtit -Përshkrimi i Fotografive, i datës 28.05.2009 (i shënjuar si fashikull 3, faqe 28, fotot origjinale mund të shihen edhe në fashikulln 2);
- Raporti ekzaminues i Mjekësisë Ligjore-Ekzaminimi balistik i armës automatike AK-47, Lab nr. 2009-1181,i datë 06 .07.2009 (i shënjuar si fashikull 3, faqe 26);
- Raporti ekzaminues kroat i analizave GSR, referencë nr: 511-01-115 / 1-6295 / 09.DT Zagreb, 18 Gusht 2009 (i shënjuar si fashikull 3, faqe 25);
- Qendra Klinike Universitare e Kosovës-Departamenti i Psikologjisë, Raporti mbi gjendjen mendore të A.C., ref nr. 145 i datës 20.05.2010 i dermatologes Dr. Y. B., Dr.sc. N. Sh. neuropsikiatër, dhe Mr.sci. N. M. Psikologe, (i shënjuar si fashikull 3, faqe 24);

29. Të mëposhtmet janë të ndryshme, aktvendimet dhe urdhrat:

- Certifikata mbi Konfiskimin e përkohshëm të sendeve nga i dyshuar A.C., NJKRPrishtinë, Çështja Nr: 2009-AG-0424, datë 23.05.2009, Prishtinë, (e shënjuar si fashikull 3, faqe 28);
- Certifikata mbi Konfiskimin e përkohshëm të sendeve nga i dyshuar R.O., NJKRPrishtinë, Çështja Nr: 2009-AG-0424, datë 23.05.2009, Prishtinë, (e shënjuar si fashikull 3, faqe 28);

□

- Kërkesa për ekspertizë / analizën e provave në laboratorin e qendrës së kriminalistikës të Kosovës, e datës 17.06.2009 (e shënjuar si fashikull 3, faqe 26); Urdhër për Laboratorin e Qendrës së Kriminalistikës në Prishtinë për të kryer ekzaminimin balistik, GJPP.no.136 / 09, Prishtine, i datës 17.06.2009 (i shënjuar si fashikull 3, faqe 26);
- Aktvendim për fillimin e hetimeve, PP.no.465-6 / 2009, i datës 26.05.2009, Prishtinë, (e shënjuar si fashikull 3, faqe 23);
- Aktakuza e Prokurorit të Shtetit. PP. nr. 465-6 / 09, i datës 13 gusht 2009 (e shënjuar si fashikull 3, faqe 20);
- Konfirmimi i Aktakuzës me aktvendim të gjyqtarit për konfirmim, KA. Nr. 348/09, i datës 05.10.2009 (i shënjuar si fashikull 3, faqe 20);
- Prosesverbali nga seanca për konfirmimin e aktakuzës të datës 05.10.2009 (e shënjuar si fashikull 3, faqe 20);
- Urdhri për të mbajtur Shqyrtimin gjyqësor, Nr. 383/09, i datës 30 tetor 2013, (e shënjuar si fashikull 4, faqe 31);
- Propozimi nga avokati mbrojtës Z. I. D. për të thirrur si dëshmitar Znj. A.C. dhe M.C., datë 18/11/2013, (e shënjuar si fashikull 4, faqe 31);
- Urdhri i gjykatës për të identifikuar vendndodhjen e provave të quajtura si NV # 14.1, NV # 14.2 dhe këmishës ngjyrë hiri, të datës 17/12/2013 (e shënjuar si fashikull 4, faqe 24);
- Kërkesë për autoritetet kompetente të Shqipërisë për Ndihmë të Ndërsjellë në Çështjet Penale, me datë 27 dhjetor 2013 (e shënjuar si fashikull 4, faqe 24);
- Kërkesë për autoritetet kompetente të Shqipërisë për ndihmën e ndërsjelltë juridike në çështjet penale të kryer ekspertizën e provave, i datës 30 janar 2014 (e shënjuar si fashikull 4, faqe 15);
- Miratimi i pushimit të lehonisë për Q. A. nga Qendra për Arsim parashkollar "Ardhmëria", Nr. 47106, i datës 15/08/2006, D., (e shënjuar si fashikull 4, faqe 22);
- Vendimi i Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit në lidhje me miratimin e pushimit pa pagesë për Q.A., nr. 467/1, i datës 09.01.2009, D. (e shënjuar si fashikull 4, faqe 22);

□

- Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës C.no.549 / 2009, i datës 25.06.2009, për ndërprerjen e martesës që u mbajt më 12.04.2006 në mes të Q. C.-mbiemri i vajzërisë A. si paditës dhe A.C. (e shënjuar si fashikull 4, faqe 22);  
Vendimet e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Qendra për mirëqenie Sociale , Drenas, QPS Nr.870, datë 13.04.2010, nëpërmjet të cilave D. C. është emëruar si kujdestare e të miturve L. (A.C.) e lindur më xxxx dhe H. (A.C. ) C., i lindur më xxxx (e shënjuar si fashikull 4, faqe 22);
- Certifikata e vdekjes e babait të A.C., tani të ndjerit H. C. i cili u nda ngajeta më 28.02.2011, e datës 02/12/2013 (e shënjuar si fashikull 4, faqe 22);
- Propozimi për dëgjim të dëshmitarit z. O.M. të datës 03/02/ 2014 (e shënjuar si fashikull 4, faqe 14);
- Kërkesa drejtuar të gjitha Gjykatave Themelore në Kosovë të zbulojë të dhënat e mëparshme penale nëse ka ndonjë për A.C. dhe R.O., të datës 03 shkurt 2014 (e shënjuar si fashikull 4, faqe 14);
- Autorizimi për zëvendësimin e avokatit mbrojtës av. I. D., i datës 07/03/2014, (e shënjuar si fashikull 5, faqe 28);
- Raport i dëshmitarit ekspert nga Shqipëria, për ekzaminimin e mostrave të marra nga mbetjet e të shtënave armëve të zjarrit, nr. 1059 Prot, i datës 10/03/ 2014, (e shënjuar si fashikull 5, faqe 26);
- Kërkesë nga A.C. që t'i kthehen sendet e tij, e datës 20/03/2014, (e shënjuar si fashikull 5, faqe 26);
- Autorizim për zëvendësimin e avokatit mbrojtës att. I.D., i datës 10/04/2014, (e shënjuar si fashikull 5, faqe 23);
- Kërkesë për autoritetet kompetente të Kroacisë për ndihmën e ndërsjelltë juridike në çështjet penale për të shprehur opinionin shtesë të ekspertizës, e datës 14 prill 2014 (e shënjuar si fashikull 5, faqe 21);
- Kërkesë për autoritetet kompetente të Shqipërisë për ndihmën e ndërsjelltë juridike në çështjet penale për të shprehur opinionin shtesë të ekspertizës, e datës 14 prill 2014 (e shënjuar si fashikull 5, faqe 20);

□

- Përgjigje e NJN-së nga SHQIPËRIA-dorëzim i opinionit shtesë të ekspertizës, e datës 19.05.2014, (e shënjuar si fashikull 5, faqe 17);
- Përgjigje e NJN-së nga Kroacia - dorëzim i opinionit shtesë të ekspertizës, klasë: 720-03 / 14-01 / 2847, ref nr. 514-06-0201-14-04, datë 23/05/ 2014, (e shënjuar si fashikull 5, faqe 14);

Aktvendim i vazhdimit derisa aktgjykimi të merr formën e prerë, i datës 9 shtator 2014, (e shënjuar si fashikull 5, faqe 9);

- Dispozitiv i aktgjykimit të shpallur të datës 9 shtator 2014, (i shënjuar si fashikull 5, faqe 9);

30. Deklaratat vijuese të dëshmitarëve dhe të dhënat e shqyrtimit kryesor të dëshmitarëve:

- Deklarata e dëshmitarit z. Sh. G. dhënë para Policisë, me datë 22.05.09 (e shënjuar si fashikull 3, faqe 28);
- Deklarata e dëshmitarit z. F. F. dhënë para Policisë, me datë 22.05.09 (e shënjuar si fashikull 3, faqe 28);
- Procesverbali i marrjes në pyetje të të pandehurit A.C. para Prokurorit Publik, datë 04.06.2009 (e shënjuar si fashikull 3, faqe 22);
- Procesverbali i marrjes në pyetje të të pandehurit R.O. para Prokurorit Publik, datë 09/06/2009 (e shënjuar si fashikull 3, faqe 22);
- Deklarata e dëshmitarit z. A. H. dhënë para Prokurorit Publik, me datë 24.06.09 (e shënjuar si fashikull 3, faqe 21);
- Deklarata e dëshmitarit z. A. J. dhënë para Prokurorit Publik, datë 24.06.09 (e shënjuar si fashikull 3, faqe 21);
- Deklarata e dëshmitarit z. Sh. G. dhënë para Prokurorit Publik, datë 12.06.09 (e shënjuar si fashikull 3, faqe 21);
- Deklarata e dëshmitarit znj. Q.A. dhënë para Prokurorit Publik, datë 17.06.09 (e shënjuar si fashikull 3, faqe 21);
- Deklarata e dëshmitarit i z. F. F. dhënë para Prokurorit Publik, datë 12.06.09 (e shënjuar si fashikull 3, faqe 21);

□

- Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të datës 15 nëntor 2013, (e shënjuar si fashikull 4, faqe 29);
- Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të datës 18 nëntor 2013, (e shënjuar si fashikull 4, faqe 29);
- Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor datës 11 dhjetor 2013 (e shënjuar si fashikull 4, faqe 22);
- Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të datës 17 janar 2014, (e shënjuar si fashikull 4, faqe 19);

- Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të datës 21 janar 2014, (e shënjuar si fashikull 4, faqe 18);
- Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të datës 23 janar 2014, (e shënjuar si fashikull 4, faqe 17);
- Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të datës 13 shkurt 2014, (e shënjuar sifashikull 5, faqe 30);
- Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të datës 7 mars 2014, (e shënjuar si fashikull 5, faqe 27);
- Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të datës 11 prill 2014, (e shënjuar si fashikull 5, faqe 19);
- Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të datës 2 korrik 2014, (e shënjuar si fashikull 5, faqe 15);
- Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të datës 5 shtator 2014, (e shënjuar si fashikull 5, faqe 8);
- Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të datës 9 shtator 2014, (e shënjuar si fashikull 5, faqe 7);
- Fjala përfundimtare e prokurorit, PP.nr. 465-6-2009, PKR.383 / 2009, e datës 5 shtator 2014, (e shënjuar si fashikull 5, faqe 10);
- Fjala përfundimtare nga av. D. R., PKR.383 / 2009, e datë 5 shtator 2014, (e shënjuar si fashikull 5, faqe 10);
- Fjala përfundimtare nga av. I.D., PKR.383 / 2009, e datës 5 shtator 2014, (e shënjuar si fashikull 5, faqe 10);

## **VI. Vlerësimi i provave:**

### **31. *Dëshmia e dëshmitares Q.A.***

Më 17 qershor 2009, dëshmitarja Q.A. ka deklaruar para prokurorit si vijon:

Q.A. dhe A.C. u takuan me njëri-tjetrin kur Q.A. ishte nëntëmbëdhjetë (19) vjeçë. Ata kishin qenë dashnorë për pesë vjet dhe më pas ata u martuan. Gjatë kësaj kohe ata kishin disa probleme të cilat nuk kanë qenë serioze. Pasi dëshmitarja lindi fëmijën e saj të parë në vitin 2007, filluan problemet. Gjatë katër viteve që ata jetuan së bashku A.C. shpesh e rrahu Q.A. për shkak të të

genit xheloz si dhe për arsyet e tjetra. Dëshmitarja i ishte nënshtruar edhe dhunës psikologjike. Një herë dëshmitarja është detyruar të kërcej nga dritarja pasi që ishte rrahur rëndë nga A.C.. Q.A. mendoi se A.C. do ta vrastë atë dhe kjo është arsyet pse ajo u hodh nga dritarja. Ajo pësoi disa fraktura në trupin e saj. A.C. u dënuat më vonë për këtë ngjarje dhe u dënuat me një dënim me kusht. A.C. dhe Q.A. u ndanë disa herë. Q.A. lindi fëmijën e dytë në vitin 2008. Në vitin 2009 Q.A. u nda sërisht nga A.C. sepse ky i fundit ishte shumë xheloz dhe po e rrihte atë. Megjithatë, ata nuk e ndalën komunikimin dhe A.C. po e luste Q.A. të kthehej në shtëpi dhe të jetonin prapë së bashku. A.C. po e fajësonte Q.A. dhe R.A.n pse ai u dënuat nga gjykata për shkak të dhunës që ai përdorte kundër Q.A..

Në ditën kritike A.C. e thirri Q.A. rrëth orës 13:30. Kjo e fundit nuk ia ka hapur telefonin A.C. Pastaj A.C. ia kishte dërguar një SMS Q.A. duke i thënë: "Eja në xhami dhe merre trupin e kalbur".

Q.A. kishte dëgjuar nga dikush që në ditën e vrasjes A.C. ishte së bashku me R. në vendin e krimtit. Ajo bile kishte dëgjuar se edhe një person i tretë ishte i pranishëm.

Për më shumë, Q.A. nuk i kishte thënë asnjëherë babai i saj që të ndahet nga A.C.. Viktima gjithmonë i kishte thënë asaj se ishte vendimi i saj të kthehej apo jo tek burri i saj.

32. Më 15 nëntor 2013, dëshmitarja Q.A. dëshmoi në gjykatë para këtij trupi gjykues. Dëshmitarja vetëm përsëriti përgjigjet që ajo i kishte dhënë para prokurorit. Asnjë provë e re nuk i është ofruar gjykatës nga ky dëshmitar.
33. Gjykata konstaton se dëshmia e këtij dëshmitari është e besueshme. Dëshmitari dhe i pandehuri A.C. kanë pranuar se ata kishin një marrëdhënie të paqëndrueshme për një kohë. Më tej, nuk është e diskutueshme se i pandehuri A.C. ka përdorur dhunën kundër këtij dëshmitari. I pandehuri A.C. bile ishte dënuar për dhunën në familje. Të gjitha faktet e rëndësishme të cilat e ndihmojnë gjykatën për të ardhur në një përfundim në lidhje me këtë rast dhe për të cilat ky dëshmitar dëshmoi nuk janë të diskutueshme. Për më tepër, dëshmia e këtij dëshmitari është vërtetuar me dëshmi të tjera të dhëna nga të pandehurit ose të dëshmitarëve të tjerë. Nga kjo dëshmi, gjykata konkludon se marrëdhënia midis Q.A. dhe të pandehurit A.C. u përkeqësua dhe nuk po funksiononte për shkak të abuzimit fizik dhe psikologjik nga i pandehuri kundër gruas së tij. Kjo dëshmi ka ndihmuar gjykatën të vij në përfundim në lidhje me motivin e vrasjes.

### **Dëshmia e dëshmitarit F.F.**

34. Më 22 maj 2009, dëshmitari e dha dëshminë e mëposhtme para policisë:

Më 22 maj 2009, dëshmitari ishte duke punuar në një barakë e cila është e vendosur në afërsi rrëth 150 metra larg nga xhamia e fshatit Z. i U.. Rreth orës 13:40 dëshmitari kishte dëgjuar disa të shtëna. Ndërsa ai po i afrohej te xhamia ai pa një Mercedes ngjyrë hiri aty pranë. Ai vërejti dy persona: një që mbante një armë automatike në dorë dhe personi i dytë ishte duar bosh. Me sa i kujtohet dëshmitarit, të dy hynë në Mercedesin ngjyrë hiri dhe personi i cili ishte duar bosh voziti veturën. Ai pa një person në afërsi të xhamisë të shtrirë në tokë pranë veturës. Më pas, policia erdhi dhe kërkoi nga dëshmitari që të jepte një deklaratë në stacionin policor në D.

35. Më 12 qershor 2009, dëshmitari e dha dëshminë e mëposhtme para prokurorit:

Më 22 maj 2009, dëshmitari ishte duke punuar në një barakë e cila ndodhet në afërsi të xhamisë në fshatin Z. i U.. Dëshmitari zakonisht nuk punon nga ora 13:30-16:00. Në ditën kritike ai mbylli barakën në ora 13:40 dhe u nis për të shkuar në shtëpi. Pas kalimit nga dhjetë metra ai ka dëgjuar disa të shtëna me armë. Nga ai vend xhamia është rrëth 150-200 metra larg. Ai pastaj eci drejt xhamisë dhe pa një veturë para xhamisë. Të dy dyert e para të veturës u mbyllën pothuajse në të njëjtën kohë dhe dëshmitari mban mend se kanë qenë dy persona në veturë, por ai nuk mund të japë përshkrim të ndonjërit prej personave. Më tej, dëshmitari deklaron se sipas mendimit të tij kanë qenë dy persona pasi që dyert e përparme të veturës u mbyllën pothuajse në të njëjtën kohë. Dëshmitari nuk e ka parë personin që e ka qëlluar viktimën, por ai e pa atë me armë automatike në dorën e tij duke hyrë në veturë. Personi me armë në dorë hyri në anën e djathtë të veturës, ndërsa ai nuk është i sigurt kush ka hyrë në anën e majtë. Ai mban mend se kanë qenë dy persona, por ai nuk mund ta thotë këtë kësaj.

Dy persona vizituan dëshmitarin dje (11 qershor 2009) në barakën e tij që të kishin një bisedë në lidhje me dëshminë që ai do ta ipse në lidhje me këtë rast. Dëshmitari kishte frikë prej këtyre dy personave, sepse ata i thanë atij që e ata e kanë parë deklaratën që ai ka dhënë para policisë dhe se ata ishin të vetëdijshëm se ai ka dëshmuar se kanë qenë dy persona në veturë. Dëshmitari i tha këtyre dy personave se ishte mendimi i tij se në veturë kanë qenë dy persona. Këto dy persona janë paraqitur të jenë nga fshati K. e N..

36. Më 17 janar 2014 dëshmitari dëshmoi para trupit gjykues. Ai tha se ai mbështet deklaratat e mëparshme që ai i ka dhënë para policisë. Në ditën kritike ai ishte në vendin e krimtit. Ai

mendon se i ka parë dy persona duke hyrë në veturë, pasi ai kishte dëgjuar të shtëna, megjithatë, ai nuk është i sigurt në lidhje me të.

37. Gjykata arrin në përfundimin se dëshmia e këtij dëshmitari është e besueshme. Ai deklaroit atë që kishte parë në ditën kritike. Megjithatë, kur vie deri tek një fakt vendimtar, i cili është se nëse ka qenë vetëm një person që ka hyrë në veturë pas të shtënave, ose ishin dy, dëshmitari nuk është i sigurt. Ai nuk ishte i sigurt kur ai dha deklaratën e tij në polici, ai nuk ishte i sigurt kur ai dha deklaratën në prokurori dhe në fund ai ishte i sigurt se sa persona ka parë në kohën kur ai dëshmoi para trupit gjyques. Është e qartë nga të gjitha dëshmitë që ai dha se ishte përshtypja e tij se kanë qenë dy persona. Ai kurrë nuk e ka treguar nivelin e sigurisë, si për atë që ka parë e cila do të kënaqte gjykatën dhe do të hiqte të gjitha dyshimet e arsyeshme dhe të vendosë faktin se i akuzuari R.O. ishte i pranishëm kur ka ndodhur vrasja. Edhe në qoftë se dëshmitari do të kishte qenë i sigurt se ishte një person i dytë në veturë së bashku me të pandehurin A.C., ai kurrë nuk e ka identifikuar personin e dytë të jetë R.O..
38. Prandaj, dyshimet lidhur me gjendjen faktike nuk duhet të interpretohen në dëm të të pandehurit. Ky person ka qenë dëshmitar kryesor i prokurorisë e cila është përpjekur të provojë fajësinë e të pandehurit R.O.. Megjithatë, ky dëshmitar nuk ka ofruar dëshmi të cilat do të bindnin gjykatën përtej dyshimit të arsyeshëm se i akuzuari R.O. ishte në vendin e ngjarjes në momentin kritik.

#### ***Dëshmia e dëshmitarit Sh. G.***

39. Më 22 maj 2009, dëshmitari i tha policisë si vijon:

Më 22 maj 2009, dëshmitari vizitoi xhaminë në fshatin Z. i U. për tu lutur. Kur ai doli jashtë xhamisë ai dëgjoi një të shtënë. Ai pa një person që kishte rënë për tokë pranë veturës së tij. Ai e pa një të ri të hyjë në një tjetër veturë e cila u drejtua në drejtim të fshatit Komoran. Ai nuk e mban mend se çfarë ngjyre ishte makina. Ai poashtu nuk mban mend nëse dikush tjetër ka qenë së bashku me të riun.

40. Më 12 qershor 2009, dëshmitari i tha prokurorit si vijon para prokurorit:

Në ditën kritike dëshmitari vizitoi xhaminë në fshatin Z. i U. për lutje. Kur ai mbaroi namazin ai doli jashtë xhamisë dhe pa që viktima u qëllua. Viktima kishte çelësat e tij në dorën e tij në momentin që ai u qëllua. Në atë moment viktima ra në tokë. Dëshmitari nuk mund të mbaj mend se sa të shtëna ai kishte dëgjuar. Personi që qëlloi viktimin hyri në veturë dhe u nis në drejtim të

fshatit K.. Dëshmitarit nuk i kujtohet nëse dikush tjetër ka qenë së bashku me vrasësin. Ai vetëm e njeh personin që e qëlloi viktimen si fytyrë. Para shtierjes në viktimen dëshmitari nuk e ka dëgjuar vrasësin të thotë ndonjë gjë. Dy ditë para se të japë intervistën në prokurori një grua e vizitoi atë në shtëpinë e tij dhe i tha atij se ai nuk është dashur të ketë dëshmuar në këtë rast. Kjo grua i tha dëshmitarit se ajo është motra e personit që e qëlloi viktimen. Gruaja u përpoq të shpjegojë konfliktin ndërmjet vëllait të saj dhe gruas së tij për 7-8 vite.

41. Më 15 nëntor 2013, dëshmitari dëshmoi para trupit gjyques. Thelbi i dëshmisë së tij është i njëjtë pasi që ai dëshmoi para policisë dhe prokurorit.
42. Ky dëshmitar ishte konsistent me atë që ai i kishte thënë policisë, prokurorit dhe në fund gjykatës. Ai ishte i pranishëm në ditën e vrasjes dhe e pa rënien e viktimes në tokë. Ai nuk ka dëgjuar ndonjë shkëmbim fjalësh midis vrasësit dhe viktimes. Më tej, ai vetëm e pa një veturë që u largua shpejt nga vendi i krimtit. Ai nuk mundi të njoh personin që qëlloi viktimen, e as nuk ishte në gjendje t'i thotë gjykatës se sa njerëz ishin në veturë. Duke pasur parasysh moshën e dëshmitarit dhe duke marrë parasysh përputhshmërinë e tij gjykata e gjen të besueshme dëshminë e këtij dëshmitari.
43. Duke marrë parasysh se ky dëshmitar nuk mundi të thotë para policisë, prokurorisë dhe gjykatës se sa njerëz ai i pa duke hyrë në veturë me A.C., gjykata arrin në perfundimin se kjo dëshmi nuk ishte e ndonjë relevance të madhe në dhënien e këtij aktgjykimi.

### ***Dëshmia e O.M.***

44. Ky dëshmitar i cili shërben si imam i një xhamie ka dhënë dëshminë e tij para gjykatës më 7 mars 2014:  
A.C. e luti imamin që të shkojë e të takojë R.A. në mënyrë që të zgjidhte pajtimin mes A.C. dhe gruas së tij Q.A.. Fillimisht imami ishte i suksesshëm për të pajtuar çiftin. Ky pajtim u zhvillua me kontributin e R. Edhe një herë A.C. dhe gruaja e tij u ndanë. Imami nuk e di se cila ishte arsyja. Edhe një herë u bënë përpjekje për t'i pajtuar ata dhe përsëri u bë pajtimi në mes të çiftit dhe përsëri me kontributin e A.C. dhe R.
45. Gjykata konstaton se kjo dëshmi vërtetohet me dëshmitë e tjera të rastit, përkatesisht dëshminë e të pandehurit A.C., dëshmitares Q.A. dhe dëshmitë e tjera të rastit. Fakti se A.C. dhe Q.A. kanë pasur probleme kurrë nuk është kontestuar nga dikush. Gjithashtu procesi i pajtimit të çiftit me ndërmjetësimin e imamit nuk është kontestuar. Prandaj, gjykata e gjen këtë dëshmi të besueshme.

46. Kjo dëshmi tregon se viktima R.A. nuk ishte një pengesë në marrëdhënien e qëndrueshme në mes të Q.A. dhe A.C.. Në fakt, dëshmitari tregon se viktima kishte bërë disa përpjekje pér të pajtuar çiftin. Kjo dëshmi, në vërtetim me dëshmitë e tjera, të tilla si deklarata e Q.A. dhe vet A.C., ndihmoi gjykatën pér të ardhur në përfundim pér motivin e kësaj vepre penale.

#### ***Dëshmia e dëshmitarit A.J.***

47. Më 24 qershor 2009, dëshmitari e dha këtë deklaratë para prokurorit:

Në ditën e vrasjes dëshmitari vizitoi xhaminë në fshatin Z. i U. pér të bërë lutjet e së premtes. Dëshmitari e njeh A.C. prej më parë, por ai nuk është shoqëruar me të. Në ditën e vrasjes dëshmitari pa A.C., kur ai doli jashtë xhamisë. Vetura e A.C. ishte në rrugën e veturës së tij dhe dëshmitari i kërkoi A.C. që të lirojë rrugën në mënyrë që ai të mund të kalojë. A.C. i tha atij që të pres disa minuta. Pas një kohe A.C. lëshoi rrugën dhe ai ishte në gjendje të kalojë. Gjatë gjithë kësaj kohe A.C. ishte i vetëm në veturën e tij i ulur në ulësen e shoferit. Dëshmitari nuk ka qenë i pranishëm kur ka ndodhur vrasja pasi që ai u nisë më herët në drejtim të D..

48. Më 18 nëntor 2013 dëshmitari dëshmoi si më poshtë para trupit gjykues:

Në ditën kritike dëshmitari vizitoi xhaminë pér lutje. Kur ai i mbaroi lutjet ai doli nga xhamia dhe shkoi pér të marrë veturën e tij. Ai e takoi A.C. vetura e të cilat e kishte bllokuar veturën e tij. Dëshmitari i tha A.C. që të lëvizë veturën e tij. A.C. ishte i hutuar dhe tha: "dy minuta" dhe pastaj ai priti një kohë dhe mandej dëshmitari e tundi dorën që t'ia përkujtonte atij pér ta larguar veturën dhe ai tha "prit 5 minuta". Pastaj dëshmitari pa A.C. duke shkuar tek vetura e tij të cilën ai e lëvizi prapa dhe pastaj ai e lëvizi veturën e tij. A.C. e ndezi motorin e veturës së vet dhe aty kishte shumë tym. Dëshmitari i tha A.C. "kushëri vetura juaj është në zjarr, por A.C. nuk i kushtoj ndonjë vëmendje kësaj. Më pas, dëshmitari vazhdoi rrugën e tij.

49. Më 18 nëntor 2013 ky dëshmitar dëshmoi para gjykatës. Thelbi i dëshmisë së tij ishte se i pandehuri A.C. ishte i vetëm në Mercedesin ngjyrë hiri në ditën kritike.

50. Gjykata vë në pah se prokuroria pretendon se ky dëshmitar nuk është i besueshëm. Megjithatë, prokurori gjatë marrjes në pyetje nuk ka ofruar asgjë që do të ulte besueshmërinë e këtij dëshmitari. Prandaj, gjykata, në mungesë të provave bindëse që do të provonin

ndryshe është e detyruar që të marrë në shqyrtim këtë dëshmi si të besueshme. Çdo dyshim në lidhje me ekzistimin e fakteve duhet gjithmonë të interpretohet në favor të të pandehurit.

### ***Dëshmia e dëshmitarit A. H.***

51. Më 24 qershor 2009, dëshmitari e dha këtë deklaratë para prokurorit:

Në ditën kritike dëshmitari së bashku me katër miq të vet, ishin duke u kthyer nga shkolla në D. në fshatin K. e E.. A.C. shpesh e voziste dëshmitarin kur ai e shihte atë duke u kthyer nga shkolla. Atë ditë A.C. nuk e ka ndalur veturën për të marrë dëshmitarin dhe miqtë e tij. A.C. nuk ishte me Mercedesin e tij të kuq, por ai po e ngiste një tjetër Mercedes i cili kishte ngjyrë hiri. A.C. ishte i vetëm në veturë.

52. Më 18 nëntor 2013 ky dëshmitar dëshmoi para gjykatës. Thelbi i dëshmisi së tij ishte se ai dëshmoi se i pandehuri A.C. ishte i vetëm në Mercedesin ngjyrë hiri në ditën kritike.

53. Gjykata vë në pah se prokuroria pretendon se ky dëshmitar nuk është i besueshmë. Megjithatë, prokurori gjatë marrjes në pyetje nuk ka ofruar asgjë që do të ulte besueshmërinë e këtij dëshmitari. Prandaj, gjykata, në mungesë të provave bindëse që do të provonin ndryshe është e detyruar që të marrë në shqyrtim këtë dëshmi si të besueshme. Çdo dyshim në lidhje me ekzistimin e fakteve duhet gjithmonë të interpretohet në favor të të pandehurit.

### ***Dëshmia e A. C.***

54. Kjo është një dëshmitare e propozuar nga mbrojtja. Ajo është motra e të pandehurit A.C. dhe bashkëshorte e të pandehurit R.O.. Më 7 mars 2014 ajo dëshmoi para gjykatës si më poshtë:

Në ditën kritike ajo u zgjua herët në mëngjes për të shkuar në vendin e saj të punës. Ajo u shoqërua nga burri i saj R.O. në vendin e saj të punës. Rreth orës 12:00 R.O. e mori atë nga shkolla ku ajo ishte duke punuar dhe ata së bashku shkuan në shtëpinë e A.C.. R.O. e parkoi veturën në vendin e quajtur "Te L.". A.C., A. dhe R.O. e pinë nga një kafe së bashku dhe pas një kohe A.C. u largua nga shtëpia pa i thënë askujt se ku po shkonte. Pas një kohe ajo pa jashtë shtëpisë A.C. me një pushkë në dorë. Ajo ishte e shokuar dhe e pyeti A.C. ku ishte duke shkuar.

Ky i fundit u përgjigj se ai u kthyte dhe se ai sapo kishte vrarë gruan e tij Q.A.. Në këtë pikë A.C. bërtiti me zë të lartë dhe i ra të fikët. Ajo nuk mban mend të ketë parë R.O. duke prekur pushkë.

55. Gjykata vë në pah se dëshmitarja është gruaja e të akuzuarit R.O., dhe motra e të pandehurit A.C.. Dëshmitari ka një motiv të fortë për të dëshmuar në një mënyrë që do të ishte në favor të të dy të pandehurve. Në anën tjetër prokuroria pretendon se ky dëshmitar nuk është i besueshëm. Megjithatë, prokurori gjatë marrjes në pyetje nuk ka ofruar asgjë që do të ulte besueshmérinë e këtij dëshmitari. Prandaj, gjykata, në mungesë të provave bindëse që do të provonin ndryshe është e detyruar që të marrë në shqyrtim këtë dëshmi si të besueshme. Çdo dyshim në lidhje me ekzistimin e fakteve duhet gjithmonë të interpretohet në favor të të pandehurit.

#### **56. Dëshmia e M.C.**

Më 17 janar 2014 dëshmitarja dëshmoi para trupit gjyques. Ajo është e aférme e dy të pandehurve, domethënë ajo është motra e A.C. ndërsa R.O. është kunati i saj. Ajo dëshmoi si më poshtë:

Ajo nuk mban mend ditën e saktë të ditës kritike. Megjithatë, atë ditë, vëllai i saj me fëmijët e vet dhe motra e saj me burrin e vet ishin të gjithë në shtëpi. Motra e saj dhe kunati erdhën si mysafirë. Dëshmitarja përgatiti kafe për ta dhe ata të gjithë pinë kafe së bashku. Pastaj dëshmitarja shkoi në dhomën tjetër për t'u bërë gati pasi që ajo kishte për të shkuar në punë. Më vonë ajo shkoi në të njëjtën dhomë ku vëllai i saj dhe kunati ishin si dhe të gjithë të tjerët. Ajo shkoi për të marrë vajzën e vëllaut të saj që ishte një foshnje dhe për të parë nëse ajo kishte nevojë për t'u ndërruar. Kur ajo ri-hyri në dhomë ajo e pa se vëllai i saj nuk ishte aty. Ajo mendonte se vëllai i saj ishte duke u kujdesur për babain e saj të paralizuar. Më vonë ajo dëgjoi një zë që erdhi nga e motra kështu që ajo kuptoi se diçka nuk ishte në rregull. Ajo shkoi atje shpejt dhe pa se të motrës i kishte rënë të fikët. Ajo nuk mund të kujdesej për motrën pasi që ajo kishte fëmijët që qanin kështu që ajo i tha të kunatit të kujdeset për motrën e saj. Kunati i saj dhe ajo dolën jashtë dhe panë vëllain i saj që po vinte duke e mbajtur në dorë armën që ai e kishte dhe më pas ai u kujdes për fëmijët. Vëllai i saj thirri policinë. Policia erdhi dhe hyri brenda nëpër dhoma. Ajo mori fëmijët dhe i çoi në shtëpinë e burrit të saj pasi që ata po qanin. Ajo nuk e di se çfarë ka ndodhur përvçe momentit kur vëllai i saj erdhi për t'i përshëndetur në oborrin e xhaxhait ku ajo ishte së bashku me fëmijët, ai i tha lamtumirë dhe iku.

57. Gjykata vë në pah se dëshmitarja është e afërme e të dy të pandehurve. Dëshmitarja ka një motiv të fortë për të dëshmuar në një mënyrë që do të ishte në favor të të dy të pandehurve. Në anën tjetër prokuroria pretendon se ky dëshmitar nuk është i besueshëm. Megjithatë, prokurori gjatë marrjes në pyetje nuk ka ofruar asgjë që do të ulte besueshmërinë e këtij dëshmitari. Prandaj, gjykata, në mungesë të provave bindëse që do të provonin ndryshe është e detyruar që të marrë në shqyrtim këtë dëshmi si të besueshme. Çdo dyshim në lidhje me ekzistimin e fakteve duhet gjithmonë të interpretohet në favor të të pandehurit.

#### ***Dëshmia e dëshmitarit ekspert N.H.***

58. Më 11 dhjetor 2013 dëshmitari ekspert dëshmoi para gjykatës. Dëshmia e këtij dëshmitari ishte se i pandehuri as në kohën e kryerjes së veprës dhe as tanë nuk ka ndonjë çrregullim të pérhershëm ose të pérkohshëm psikotik. Më tej, eksperti deklaroi se niveli aktual i funksionit intelektual përjashton mundësinë e diagnostikimit të mangësisë mendore. Dhe në fund eksperti deklaroi se në kohën e kryerjes së veprës penale pacienti ishte në gjendje për të kuptuar rëndësinë dhe pasojat e veprës.

59. Mendimi i ekspertit në këtë çështje në fakt nuk kontestohet nga palët. Gjykata gjen dëshminë dhe raportin e përgatitur nga dëshmitari ekspert si bindës dhe të besueshëm.

60. Kjo është dëshmi e rëndësishme që tregon se i pandehuri nuk vuante nga ndonjë çrregullim mendor.

#### ***Dëshmia e dëshmitarës eksperte N. M.***

61. Më 17 janar 2014 dëshmitari ekspert dëshmoi para trupit gjykues dhe në thelb ajo tha se i pandehuri tregoi disa përgjegjësi emocionale, por pa asnjë dëmtim të personalitetit.

62. Gjykata vë në pah se ky konstatim nuk është kontestuar nga palët. Përveç kësaj gjykata gjen dëshmitarin dhe raportin e përgatitur nga dëshmitari si të besueshëm.

63. Kjo është dëshmi e rëndësishme e cila dëshmon se i pandehuri A.C. nuk ka vuajtur nga ndonjë çrregullim i personalitetit i cili në rastin më të mirë do të ishte konsideruar vetëm si një rrëthanë lehtësuese.

### **NJN e parë nga Republika e Kroacisë**

64. Me 18 gusht 2009, eksperti D. T. që punon për Ministrinë e Brendshme të Kroacisë, përkatësisht Qendra e shkencës së forenzikës brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, ka kryer ekspertizën e mëposhtme:

#### **Dëshmi për shqyrtim:**

D # 1 Mostrat e mbledhura me paisjen për mbledhjen e mbetjeve nga e shtëna me armë (MSHA)nga dora e djathtë e R.O.

D # 1.1 Mostrat e mbledhura me paisjen MSHA nga dora e majtë e R.O. D

# 2 Mostrat e mbledhura me paisjen MSHA nga dora e djathtë e A.C.

D # 2.1 Mostrat e mbledhura me paisjen MSHA nga dora e majtë e A.C.

Pyetjet:

1. Të kryhen ekzaminimet në provat e përmendura më lart.
2. Në qoftë se është e mundur të konstatohen mbetjet nga e shtëna me armë në provat e përmendura më lart dhe për të konstatuar nëse i dyshuar ka shtjerë me armë zjarri.

#### **Përfundim:**

1. Grimcat nga mbetjet e të shtënët me armë janë gjetur në mostrën D # 1
2. Asnjë grimcë nga mbetja e shtënies me armë nuk është gjetur në mostrën në pikë D # 1.1, D # 2 dhe D # 2.1

65. Kjo është një ekspertizë e cila duket profesionale dhe e besueshme. Palët nuk e kundërshtojnë atë. Rëndësia e kësaj pjese të provave është se ajo ka ngritur dyshime nëse i akuzuari R.O. ishte së bashku me të pandehurin A.C., kur ai ka kryer vrasjen në ditën kritike. Megjithatë, ky është vetëm një dyshim dhe teza e prokurorisë ishte dëmtuar rëndë me mendimin e ekspertit që erdhi nga NJN e dytë nga Kroacia.

## **NJN e dytë nga Republika e Kroacisë**

66. Më 14 maj 2014, pas një Kërkesë për NJN nga kjo gjykatë, dëshmitari ekspert D. T. u morr në pyetje në mënyrë që të sqarojë ekspertizën e tij të datës 18 gusht 2009. Eksperti deklaroi se ai mbetet pranë gjetjeve të raportit të tij. Megjithatë, ai deklaroi si më poshtë :

### **Pyetje:**

A është e mundshme të transferohen grimcat ose mbetjet nga shtënia me armë zjarri, të cilat krijohen, kur një plumb lirohet nga një armë zjarri, nga personi (në këtë rast i pandehuri, A.C.) i cili dyshohet se qëlloi me armë, tek një person tjetër (në këtë rast i bashkë-pandehuri, R.O.) i cili pohon se nuk ka pasur asnjë kontakt me armë, vetëm duke i shtrënguar duart?

### **Përgjigje:**

Kjo është e mundur kur një person i cili ka gjuajtur nga një armë zjarri vie në kontakt me një person tjetër, të tilla si shtrëngim duarsh, grimcat MSHA kalojnë nga ky i mëparshmi tek ky i fundit. Ju lutem vëreni se diku rrëth 4 orë pas të shtënave 90% apo edhe të gjitha këto grimca mund të bien nga shuplakat e duarve pasi që ato janë në sipërfaqe të shuplakës apo ndonjë objekti tjetër, dhe nuk janë të ngjitura për të.

Nëse gjuajtësi lan duart e tij tërësisht pas të shtënave, të gjitha grimcat mund të bien në gjysmën e parë të orës. Megjithatë, nëse ai, për shembull, e vendosë armën e zjarrit në xhepin e tij para se t'i laj duart dhe pastaj prek armën e zjarrit apo disa nga pjesët e saj pas larjes ose të nesërmén, grimcat mund të kalojnë mbi shuplakën e tij përsëri dhe nëse pas kësaj ai shtrëngon duart me dikë ato mund të kalojnë në duart e atij personi.

[...].

Unë dua të them, se grimcat nga ajo armë automatike apo nga shuplaka e A.C. mund të kenë kaluar nga shuplaka e R.O. kur A.C. ka hyrë në veturë, nëse R.O. ka kapur armën ose në ndonjë mënyrë tjetër ka ardhur në kontakt me A.C. ose me armë, qoftë në veturë, në vendbanimin e A.C. ose në çfarëdo kohe para se policia të ketë marrë gjurmët nga shuplakat e tyre.

67. Kjo dëshmi ishte e dëmshme në minimin e tezës së prokurorit i cili pretendonte se i pandehuri R.O. ka ndihmuar të pandehurin A.C. në kryerjen e vrasjes. Kjo dëshmi ka ngritur dyshime të arsyeshme për atë nëse i pandehuri ishte i pranishëm dhe në këtë mënyrë ka ndihmuar të pandehurin A.C. në kryerjen e veprës penale. Shtrëngimi i duarve me të pandehurin tjetër A.C. (e cila është pretenduar nga të dy të pandehurit se ka ndodhur) mund të ketë qenë burim i mbetjeve të barutit të gjetur në dorën e djathjtë të të pandehurit R.O..

### ***NJN e parë nga Republika e Shqipërisë***

68. Autoritetet shqiptare u përgjigjën më 10 mars 2014 pas kërkesës për ndihmë juridike ndërkombëtare të datës 28 janar 2014. Përbajtja e ekspertizës është si më poshtë:

#### **Dëshmitë:**

NV # 14.1 (Mostra për grimcat e barutit të marra me pambuk në pjesën e jashtme, pranë xhamit të derës së përparme të anës së djathjtë të veturës);

NV # 14.2 (Mostra për grimcat e barutit të marra me pambuk në pjesën e brendshme, pranë xhamit të derës së përparme të anës së djathjtë të veturës) dhe

Nr 01 këmisha ngjyrë hiri (M 39/40 Westbury Bodytrash), e marrë nga i pandehuri R.O..

#### **Pyetje:**

Ekzaminimi do të kryhet në atë mënyrë që të përcaktoj praninë e mundshme të barutit i cili do të shpërndahej në procesin e qitjes së municionit nga arma e zjarrit dhe dëshmuese për pjesën e mbetur të zbrazjes fillestare të municionit nga provat e përmendura më lart NV # 14.1, NV # 14.2, dhe Nr 01 këmisha ngjyrë hiri (M 39/40 Westbury Bodytrash).

Nëse mund të kryhet një ekzaminim i tillë, sa kohë do të kalojë derisa rezultati i një ekzaminimi të tillë mund të dihet?

**Përgjigje:**

Në rrobat dhe pambukun që i janë nënshtruar eksperimentimit, nuk është evidentuar asnjë prani e nitrateve dhe nitriteve që janë të pranishme si një faktor shtesë e të shtenit.

69. Kjo ekspertizë është bërë për të përcaktuar nëse mbetjet e barutit mund të gjenden në rrobat që supozohet se R.O. i kishte të veshura në ditën që u zhvilluan të shtenat. Rezultati ishte negativ dhe kjo forcon pretendimet e të pandehurit R.O. se mbetjet e barutit që janë gjetur në dorën e tij të djathtë kanë ardhur nga shtrëngimi i duarve që ai kishte pasur me të pandehurin A.C..

**NJN e dytë nga Republika e Shqipërisë**

70. Autoritetet shqiptare u përgjigjën më 19 maj 2014 lidhur me kërkesën për ndihmë juridike ndërkombëtare për autoritetet shqiptare të datës 14 prill 2014. Përbajtja e ekspertizës është si më poshtë:

**Pyetje:**

Duke iu referuar raportit të datës 10 mars 2014 ju lutemi na thoni mendimin tuaj nëse kryerja e një analize të këtyre artikujve të provave, pasi që një periudhë prej pesë viteve ka kaluar, e bën të pamundshme përcaktimin e pranisë së mbetjeve nga të shtenat me armë zjarri të krijuara gjatë procesit të zbrazjes së një armë zjarri.

**Përgjigje:**

Lidhur me përcaktimin e kohëzgjatjes së mbetjeve të depozituara të të shtenave që dalin nga baruti, në vendin e depozituar nuk ka asnjë formulë të caktuar, por ato mund të mbijetojnë shumë gjatë që mund të jetë deri në 5 vite në rast se ne nuk e lëvizim atë nga vendndodhja mekanike e depozituar, si lëvizja e saj apo pastrimi i saj. Kjo pohohet në bazë të përvjës.

71. Kjo dëshmi tregon se në qoftë se ruhet siç duhet, kalimi i viteve nuk është një pengesë për të përcaktuar nëse ekzistojnë mbetje të barutit në rroba. Me sa duket rrobat që janë testuar ishin ruajtur siç duhet nga Policia e Kosovës dhe rezultati është negativ për mbetje të barutit.

### ***Dëshmitarë të tjera dhe dëshmi të dokumentuara***

72. Gjykata dëgjoi si dëshmitarë disa policë të Kosovës, përkatësisht L. R., E. G., R.B. dhe Sh. B. Të gjithë ata ishin të përfshirë në hetimin e kësaj vrasje dhe kanë ndërmarrë veprime brenda kompetencave të tyre.
73. Oficer i PK L.R. ishte një hetues në këtë rast. Ai përgatiti kallëzimin penal, si dhe përgatiti raportin e Vendit të Inspektimit i cili përbledhi provat të cilat janë konfiskuar në vendin e krimtit. Dëshmitari qëndroi pranë raporteve të përgatitura nga ai gjatë fazës hetimore.
74. Oficerja e PK E. G. ishte e ngarkuar me marrjen e veprimeve hetimore të inspektimit të vendit të ngjarjes, duke marrë mostra të barutit nga të dy të dyshuarit në Stacionin e Policisë në Gllogovc, duke qenë e pranishme gjatë autopsisë dhe duke bërë fotografi së bashku me R. B. Ajo ka marrë pjesë në ekzaminimin e mjetit së bashku me oficerin tjetër të PK-së Sh. B. Dëshmitari mbeti pranë raporteve të përgatitura nga ajo gjatë fazës hetimore.
75. Oficeri i PK R. B. ishte pjesë e ekipit i cili ka ekzaminuar vendin e krimtit. Dëshmitari mbështeti raportet që ishin përgatitur gjatë veprimeve hetimore në të cilat ai mori pjesë.
76. Oficeri i PK Sh. B. ishte i ngarkuar me ekzaminimin e Mercedesit me targa 479 KS 450, në bazë të kërkesës nga hetuesit e rastit. Ai mori mostrat nga xhami i jashtëm dhe i brendshëm i derës së djathtë (përballë shoferit) të veturës. Këto mostra më vonë janë ekzaminuar. Mostrat janë shënjuar si 14.1 (ana e brendshme e xhamit) dhe 14.2. (ana e jashtme).
77. Gjykata vë në pah se dëshmia e këtyre dëshmitarëve mbështet vetëm dokumentacionin që ishte përgatitur nga policia gjatë fazës hetimore. Ata dëshmuant në lidhje me shpjegimin e asaj se çfarë masash hetimore ishin ndërmarrë dhe përfshirja e tyre. Dëshmja e tyre është e besueshme dhe përfshirja e tyre nuk është kundërshtuar nga askush.

### ***Deklaratat e të pandehurit A.C.***

78. Më 22 maj 2009, i pandehuri A.C. përdori të drejtën e tij për të heshtur para policisë.
79. Më 4 qershor 2009, i pandehuri A.C. e dha dëshminë e mëposhtme para prokurorit:

Unë kam qenë i martuar me vajzën e viktimës R.A. për pesë vjet dhe kemi pasur dy fëmijë. Ne kishim një marrëdhënie të qëndrueshme derisa fëmija i parë ka lindur. Nga ky moment marrëdhënia jonë ka filluar të përkeqësohet për shkak të ndikimit të viktimës në Q.A.. Unë u dënova me dy vjet e gjysmë dënim me kusht për shkak të përdorimit të dhunës fizike ndaj gruas time Q.A.. Çifti u nda rrëth dhjetë herë para ngjarjes tragjike. Pasi ata u ndanë për herë të fundit, A.C. ka dërguar shumë njerëz tek viktima, në mënyrë që ta bind atë për të lejuar Q.A. të shkojë përsëri në shtëpinë e A.C. dhe të jenë së bashku përsëri. Këto përpjekje ishin të kota. A.C. i shkroi shumë SMS-a gruas së tij Q.A. duke i kërkuar asaj që të bashkohen, por kjo e fundit nuk pranoi. A.C. mendonte se arsyaja kryesore që ata nuk mund të ishin së bashku ishte ndikimi i viktimës mbi gruan e tij. Në ditën kritike, më 22 maj 2009, A.C. u zgjua rrëth orës 11:00 dhe shkoi në D. së bashku me djalin e tij. Ai dërgoi lule në varrin e nënës së tij. A.C. e thirri R.O. në telefon dhe e kuptoi se ai ishte në një kafene të quajtur "L." në D.. Pas kësaj, A.C., së bashku me djalin e tij, shkoi në këtë lokal dhe u takua me R.O.. Ata qëndruan së bashku për një kohë dhe pastaj A.C. së bashku me djalin e tij u nisën, ndërsa R.O. mbeti në këtë kafene. Përafërsisht rrëth orës 12:30, A.C. mbërriti në shtëpinë e tij në K.. Gjersa ishte duke u kthyer në shtëpi ai e pa veturën e viktimës të parkuar në afërsi të xhamisë në fshatin Z. i U..

Pas një kohe në shtëpinë e A.C. erdhi R.O. me gruan e tij e cila ishte motra e A.C.. R.O. dhe gruaja e tij e vizitonin shtëpinë e A.C. çdo ditë, pasi që gruaja e O. (motra e A.C.) kujdesej për të dy fëmijët e A.C. dhe Q.A.. A.C. dhe R.O. pinë kafe së bashku. Më pas, A.C. mori pushkën automatike që ai kishte në shtëpinë e tij, mori veturën e R.O. dhe u nis në drejtim të xhamisë në fshatin Z. i U.. Ai e mori veturën e R.O., sepse ai donte që viktima të mos e njihtë atë përndryshe ai do të ikte. Ai shkoi në xhami dhe priti për viktimin të dal nga xhamia. Pas një kohe ai pa se viktima po i afrohej veturën së vet ku A.C. doli nga makina dhe iu afroa viktimës. A.C. i tha viktimës "Ku je R., tash pesë muaj ju po e ndalon i vajzën tuaj të kthehet te unë, nuk po më jepni asnjë përgjigje dhe fare nuk po gjaloheni për këtë". Viktima hapi derën e veturës së tij dhe A.C. mendoi se ai ishte duke marrë diçka dhe kjo ishte arsyaja pse A.C. filloi të shtiej në drejtim të tij. A.C. nuk e di se sa herë e qëlloi viktimin. A.C. e mban mend dikë të ketë thënë fjalët "Allah Allah" pasi ai e qëlloi viktimin. Pasi A.C. e vras viktimin ai i shkroi një SMS gruas së tij duke i thënë "eja në xhami dhe merre trupin e kalbur". Pas kësaj, A.C. shkoi në shtëpi për t'i pëershëndetur fëmijët dhe familjen e tij dhe menjëherë e thirri policinë.

80. Deklarata e A.C. e dhënë para gjykatës në përgjithësi është e besueshme. Shumica e tregimit të tij është e mbështetur gjithashtu edhe nga provat e tjera. Deklarata e tij nuk është e besueshme kur ai përpinqet të përshkruaj viktimin si burim i problemeve të tij dhe të divorcit me gruan e tij. Kjo është në kundërshtim me deklaratat e Q.A. dhe deklaratën e imamit O.M.. Ky shpjegim është në kundërshtim me provat e tjera të çështjes dhe gjykata e gjen atë si të pabesueshme.

81. Pjesa tjetër e e shpjegimit të tij vërtetohet me dëshmitë e tjera të këtij rasti. Ai deklaron se ai e ka kryer vrasjen i vetëm e cila vërtetohet me deklaratën e të pandehurit tjetër R.O., si dhe ekspertizave të kryera nga ekspertët në Shqipëri dhe Kroaci. Më tej, dëshmja e tij është vërtetuar nga dëshmitarët që ishin propozuar nga mbrojtja: A.J., A. H., A. C. dhe M.C.. Të gjithë këta dëshmitarë e vendosin të pandehurin R.O. në një vend të ndryshëm nga skena e krimtit në këtë moment kritik.

#### ***Deklaratat e të pandehurit R.O.***

82. Më 23 maj 2009, i akuzuarit R.O. dha dëshminë e mëposhtme para Policisë së Kosovës:

R. G. vizitoi shtëpinë e të pandehurit A.C. në ditën e vrasjes rreth orës 12:30 së bashku me gruan e tij. Dëshmitari po e ngiste një veturë Mercedes ngjyrë hiri C220 dhe ai parkoi veturën e tij rreth 30 metra larg nga shtëpia e të pandehurit A.C.. Në kohën e vizitës A.C. ishte në shtëpinë e tij. A.C. dhe R.O. pinë kafe së bashku. Dhjetë minuta pas mbërritjes së R.O., A.C. u largua nga shtëpia, ndërsa R.O. qëndroi brenda në shtëpi duke shikuar TV. R.O. i telefonoi A.C. pasi ai u largua nga shtëpia dhe ky i fundit i tha atij se ai do të kthehet në shtëpi shumë shpejt. Pas një kohe, A.C. u kthye në shtëpi. Ai kishte një Kallashnikov në duart e tij dhe i tha të pranishmëve në shtëpi se ai kishte qëlluar një person, përkatësisht babain e gruas së tij. Më pas, A.C. e njoftoi policinë për incidentin.

83. Më 9 qershor 2009, i pandehuri R.O. dha dëshminë e mëposhtme para prokurorit:

R.O. është i martuar me motrën e A.C., A.. Ata të dy jetojnë në një banesë në fshatin B.. A. punon në fshatin K. e E. si mësuese. Në ditën e vrasjes në mëngjes ai e kishte shoqëruar gruan e tij në vendin e saj të punës. Më pas, ai u takua me A.C. në D. dhe kaluan pak kohë së bashku. Ata biseduan me njëri-tjetrin vetëm për një pasaportë. Ata qëndruan së bashku për rreth 15-20 minuta dhe pastaj R.O. u nis në drejtim të fshatit K. e E. për të marrë gruan e tij. Së bashku me gruan e tij ata shkuan në shtëpinë e A.C.. Ata vizitonin shtëpinë e A.C. çdo ditë për shkak se A. kujdesej për fëmijët e A.C.. Ata arritën aty rreth orës 12:30 dhe A.C.

ishte në shtëpi në atë kohë. R.O. e la veturën në oborrin e shtëpisë së A.C.. Çelësat e makinës ishin brenda në veturë. R.O. piu kafe së bashku me A.C. dhe ky i fundit pas një kohe doli dhe nuk tregoi se ku po shkonte. Pas 30 minutave, A.C. e thirri R.O. me telefon duke i kërkuar falje që i duhej të shkonte dhe e informoi R.O. se nuk do të vonohej dhe pastaj do të kthehet në shtëpi. R.O. nuk e dinte se A.C. e kishte marrë veturën e tij, kur ai kishte dalë për shkak se ai nuk e kishte pyetur për këtë. Pas pak kohe A.C. u kthyte në shtëpi me një Kallashnikov në duart e tij. A.C. tha se ai e vrapu babain e gruas së tij. A.C. i kërkoi falje R.O. për përdorimin e veturës së tij. Më pas, A.C. e njoftoi policinë për incidentin. I ballafaquar me deklaratën e dëshmitarit F.F.t i cili ka deklaruar se A.C. ishte së bashku me një person tjeter i cili ishte duke e ngarë veturën, R.O. deklaroi se ai nuk ishte së bashku me A.C. në kohën e vrasjes.

84. Më 13 shkurt 2014, R.O. deklaroi para gjykatës si vijon:

Në ditën e vrasjes R.O. u zgjua herët për të dërguar gruan e tij në vendin e punës së saj nga B. në fshatin K.. R.O. e la gruan e tij në shkollë dhe shkoi në D.. Ai u takua me A.C. në një pizza restoran në D. dhe ata diskutuan diçka në lidhje me një pasaportë. Ai qëndroi atje deri në 11:30, kur ai u nis në drejtim të fshatit K. për të marrë gruan e tij. Së bashku me gruan e tij, A.C. shkoi në shtëpinë e A.C. dhe ata mbërritën atje rrëth orës 12:30. R.O. piu kafe së bashku me A.C. Më pas, ky i fundit doli jashtë dhe R.O. së bashku me gruan e tij dhe fëmijët e A.C. qëndruan në shtëpi. Gjersa R.O. ishte duke e shikuar TVnë, A.C. i telefonoi atij dhe e pyeti nëse ai ishte i mërzitur dhe e njoftoi se nuk do të vonohet dhe do të kthehet së shpejt. Pas një kohe A.C. u kthyte në shtëpi me Kallashnikov dhe tha se ai e kishte vrarë gruan e tij Q.A. Në atë kohë gruas së R.O. i ra të fikët. Më vonë erdhi policia dhe ia vuri A.C. duart në pranga. Në atë moment ky i fundit i kërkoi falje R.O. që ia kishte përdorur veturën e tij. Ata shtrënguan duart së bashku dhe A.C. u morr nga Policia e Kosovës.

85. Gjykata vë në pah se deklaratat e dhëna nga i pandehuri para Policisë së Kosovës, Prokurorit të Shtetit dhe gjykatësit kanë disa mospërputhje në mes njëra-tjetrës. Megjithatë, vlen të përmendet se elementet kryesore të këtij rrëfimi kanë mbetur të njëjtë si kur është marrë në pyetje për herë të parë nga Policia e Kosovës. I pandehuri paraqiti tezën e tij mbi atë që ka ndodhur në ditën kritike. Rrëfimi i këtij të pandehuri ishte më së paku i suksesshëm në paraqitjen e një dyshimi të arsyeshëm se teza e prokurorit nuk qëndron. Ai deklaroi se në momentin kritik nuk ishte bashkë me të pandehurin A.C. në vendin e krimtit. Kjo mbështetet nga deklarata e të pandehurit A.C. dhe të gjithë dëshmitarët e propozuar nga mbrojtja. Përveç kësaj, raportet e ekspertizës të kryera nga ekspertët shqiptarë dhe kroatë mbështesin teorinë e këtij të pandehuri. I pandehuri ka

deklaruar se ai është përshëndetur me dorë me të pandehurin A.C. para se ky i fundit të jetë arrestuar dhe ekspertiza konkludon se është e mundur që mbetjet nga të shtënët me armë zjarri të jenë transferuar nga shuplaka e A.C. tek ajo e R.O. Prandaj, in *dubio pro reo*.

## **VII. Kualifikimi ligjor:**

86. Vrasja është kryer nga i pandehuri me dashje, gjakftohtë dhe në mënyrë të paramenduar. Motivi për këtë vrasje është pa dyshim një hakmarrje e paskrupullt dhe për motive të ulëta. I pandehuri vrau babain e gruas së tij, sepse viktima kishte mbështetur vajzën e tij. Në mendjen e të pandehurit viktima ishte shkaku kryesor që ai u nda nga gruaja e tij. Në anën tjetër, dëshmitë e rastit tregojnë qartë se viktima nuk kishte bërë kurrfarë dëmi ndaj të pandehurit. Motivi i ulët i të pandehurit është i treguar qartë në tekstin e mesazhit SMS që ai i ka dërguar gruas së tij menjëherë pas vrasjes. Edhe në qoftë se provat e rastit do të tregojnë se viktima i kishte sugjeruar vajzës së tij për të lënë burrin e saj i cili e kishte keqtrajtuar fizikisht dhe psikologjikisht, kjo nuk do të ishte kurrfarë mbrojtje për të pandehurin A.C.. Ajo prapë do të ishte një vrasje të rëndë.

87. Prandaj, interpretimi i mbrojtjes se i pandehuri A.C. ka kryer Vrasje në kundërshtim me nenin 146 të KPK-së thjesht nuk mbështetet me dëshmi. Në anën tjetër, gjykata e ndan mendimin e prokurorit, i cili është i mbështetur me dëshmi të rastit se i pandehuri A.C. ka kryer vrasje të rëndë në kundërshtim me nenin 147, paragrafi 1, pika 9 e KPK-së (2003).

88. Sa i përket të pandehurit R.O. pasi që gjykata nuk ka mund të konstatojë faktet të cilat janë të nevojshme për të formuar elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar, e vetmja pasojë është lirimi nga kjo akuzë.

89. Sa i përket pretendimit të mbrojtjes se vepra penale e posedimit të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 i KPRK është përfshirë në Ligjin 04 / L-209 për amnistit gjykata nuk pajtohet me këtë interpretim sipas nenit 4 (1.3) të Ligjit për Amnistinë përcakton se amnistia nuk është dhënë për veprat penale të cilat kanë rezultuar në lëndime të rënda trupore ose vdekje. Në rastin konkret vepra penale ka rezultuar në vdekje. Prandaj, gjykata është e mendimit se kjo vepër penale nuk është e mbuluar nga amnistia.

### **VIII. Dënim:**

90. Gjykata vlerësoi rrethanat rënduese dhe lehtësuese gjatë shqiptimit të dënimit.
91. Gjykata konsideroi rrethanë rënduese faktin se i pandehuri ka kryer veprën penale në mënyrë të paramenduar, në një vend publik dhe para shumë njerëzve. Vrasja është kryer për hakmarrje të paskrupullt. Përveç kësaj, si rrethanë rënduese është konsideruar sjellja e të pandehurit menjeherë pas vrasjes duke i thënë vajzës së viktimës në një gjuhë nënçmuese që ai e vrapu atin e saj.
92. Gjykata konsideroi si rrethanë lehtësuese faktin se i pandehuri ishte korrekt dhe bashkëpunues me gjykatën dhe me autoritetet në të gjitha fazat e procedurës penale, si dhe faktin se i pandehuri është baba i fëmijëve të mitur.

### **IX. Kostoja e procedurës penale:**

93. Gjykata vendosi sipas nenit 453 paragrafët 1 dhe të KPP-së se kostoja e procedurës penale do të kompenzohet pjesërisht nga A.C. në një shumë të caktuar prej 100 euro dhe kostoja e mbetur e procedurës penale do të paguhet nga burimet buxhetore. Kjo është për shkak të faktit që burimet financiare të familjes së A.C., pasi ai ishte vënë në paraburgim janë ulur ndjeshëm dhe imponimi i të gjithë shumës së procedurës për të pandehurin ose familjen e tij do të jetë një barrë e madhe për ta.

### **X. Kërkesa pasurore:**

94. Pasi që të dhënrat e mbledhura në procedurën penale nuk paraqesin bazë të sigurt përgjykim të plotë e as të pjesërishëm, gjykata në pajtim me nenin 463 (2) të KPK ka vendlodhi të udhëzojë të dëmtuarën që ajo mund ta realizojë kërkesën pasurore në gjykatën civile.

### **XI. Përfundim:**

95. Duke shqyrtau me kujdes të gjitha provat e rastit dhe duke dëgjuar të gjithë dëshmitarët e propozuar, trupi gjyku ka ardhur në përfundim se është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri A.C. ka kryer veprën penale siç akuzohet në aktakuzë, ndërsa gjykata erdhi në përfundim se nuk ka prova të nevojshme të të provuarit përtej dyshimit të arsyeshëm se i akuzuari R.O. ka kryer veprën penale për të cilën ai është akuzuar.

96.Prandaj, gjykata vendosi si në dispozitiv.

**Piotr Bojarczuk**  
**Kryetari i trupit gjykues të EULEX-it**

**Tsvetelina Zhekova**  
**Procesmbajtëse**

**Këshillë Juridike:** Personat e autorizuar (të pandehurit, prokurori dhe pala e dëmtuar) mund të paraqesin ankesë kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën e Apelit përmes kësaj gjykate. Ankesa mund të paraqitet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.